

N

JESIA ADM. KALLMET

ADMINISTRATOR: NDUE ZEFI (PD)

TERRITORI

Sipërfaqja : 18.1 km²

Koordinatat gjeografike janë :41°50'30"N 19°41'21"E

Temperatura e Janarit arrin 6-10 gradë, ndërsa e Korrikut 25-26 gradë. Reshjet shkojnë rreth 1300-1500 mm shi në vit.

Ka katër fshatra : Kallmet i Madh, Kallmet i Vogël, Rrabosht, Merqi.

Qendra e njesise adm. është Kallmeti

DEMOGRAFIA

Popullsia (Janar 2012): 7016 banorë

Dendësia: 387 banorë/km²

Familje (Janar 2012) : 1603

Në Kallmet janë ngritur monumente të rëndësisë historike-kulturore si :

1-Kisha e Eufemisë e shek.13-të i cili është vend i shenjtë, ku vijnë besimtarë nga gjithë Lezha çdo të premte dhe është vlerësuar nga Këshilli i Qarkut Lezhë si monument i rëndësisë së veçantë.

2-Kisha e Shën Gjonit,Merqi (më 1703 u mbloodh Kuvendi i Arbërit)

Kallmeti është i pasur me burime natyrore uji, me kullota dhe me ullinj shekullorë. Kallmetasit janë bujq dhe vreshtarë të mirë, ata krijuan varietetin e rrushit kallmet, fasulen me emrin kallmet dhe ullirin kokërr madh që përmendet në literaturën shkencore bujqësore.